

SKEDË INFORMATIVE
MBI DOKUMENTACIONIN PËR PENSION FAMILJAR

Kushtet për të përfituar një pension familjar, sipas sipas nenit 40, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", të ndryshuar, janë:

1. Moshë;
2. Periudha e sigurimit.

Ndërsa dokumentacioni i detyrueshëm për të përfituar pension familjar, është si më poshtë:

Nr.	Dokumentacioni i detyrueshëm	Institucioni që lëshon dokumentin
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi
2	Certifikatë vdekjeje (të jetë shënuar shkak i vdekjes)	Zyra e Gjendjes Civile
3	Certifikatë familjare	Portali e-Albania, DRSSH
4	Certifikatë lindjeje personale të fëmijëve përfitues	Zyra e Gjendjes Civile
5	Certifikatë martese e të ndjerës (e detyrueshme vetëm për femrat)	Zyra e Gjendjes Civile
6	Librezë pune e të ndjerit/të ndjerës	Qendra e Punës
7	Librezë kontributesh e të ndjerit/të ndjerës	Qendra e Punës
8	Vërtetim për periudhën e Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak të të ndjerit	Qendra e Personel Rekrutimit

Dokumentacioni shtesë në rastet e mungesës së Librezës së Punës dhe asaj të Kontributeve të të ndjerit:

1	Vërtetim nga Qendra e punës për periudhat e punës	Qendra e Punës
2	Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut që nga viti 1994 deri në vitin 2011	Qendra e Punës
3	Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut që nga viti 2012 deri në momentin e lënies së punës	Portali e-Albania, DRSSH
4	Vërtetim i pagesës së papunësisë (asistencë)	Zyra e Punës
5	Vendim gjykate për njohje vjetërsie në punë	Gjykata
6	Mandat-pagesat për derdhjen e kontributeve	Vetë personi
7	Vërtetim për Pagesën kalimtare (si ushtarak)	Qendra e Punës

Dokumentat shtesë në rastet kur i ndjeri ishte ish - i dënuar politik:

1	Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
2	Dëshmi penaliteti – vërtetim i gjendjes gjyqësore	Zyra e Gjendjes Gjyqësore

Dokumentacioni shtesë kur të ndjerit i ndryshojnë gjeneralitetet:		
1	Vërtetim nga Njësia Administrative/Bashkia për ndryshimin e gjeneralitetit	Bashkia/Njësia Administrative
2	Vërtetim nga qendra e fundit e punës për gjeneralitetin	Qendra e Punës

Dokumentacioni shtesë kur i ndjeri/e ndjera ka punuar si kuadër në ish-kooperativë bujqësore:		
1	Vendimi i emërimit në punë, si kuadër	Arkiva e Shtetit
2	Diploma e shkollës së mesme/lartë	Drejtoria Arsimore/Shkolla e Lartë

Dokumentacioni për përfitimin e pensionit familjar nga bashkëshortja/bashkëshorti:		
1	Vërtetim nga Njësia Administrative/Bashkia që i ndjeri ka bashkëjetuar me përfituesin	Bashkia/Njësia Administrative
2	Vërtetim nga dega e tatim-taksave për bashkëshortin/bashkëshorten	Drejtoria Rajonale e Tatim - Taksave/Portali e-Albania, DRSSH
3	Vërtetim si kërkues pune	Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Dokumentacioni shtesë për përfitimin e pensionit familjar nga fëmijët:		
1	Vërtetim nga shkolla kur fëmija është mbi 18 – 25 vjet	Institucioni Arsikor
2	Vërtetim nga dega e tatim-taksave për pjestarët që janë në ngarkim	Drejtoria Rajonale e Tatim - Taksave/Portali e-Albania, DRSSH
3	Vërtetim si kërkues pune	Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Dokumentacioni shtesë për kompensimin e energjisë elektrike:		
1	Vërtetim për pagesën e energjisë elektrike	OSSHE
2	Deklaratë për kompensimin e energjisë	Vetë personi, sipas formatit të ALSSH-së

Dokumentat për të përfituar pension familjar suplementar shtetëror, konform neneve 12, 13, të Ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, i ndryshuar:		
1	Fotokopje e Kartës së Identitetit	Vetë personi
2	Certifikatë familjare	Portali e-Albania, DRSSH
3	Vërtetim i vjetërsisë në shërbim/detyrë/funksion	Qendra e Punës
4	Vërtetim i pagës referuese të detyrës/funksionit	Qendra e Punës
5	Vërtetim e gjendjes gjyqësore	Zyra e Gjendjes Gjyqësore

Dokumenta shtesë për pension familjar suplementar si ish-ushtarak, konform neneve 19, 21, të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 i ndryshuar:		
1	Fotokopje e Kartës së Identitetit	Vetë personi
2	Certifikatë familjare	Portali e-Albania, DRSSH